



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 33-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 26.09.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rrustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gjentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Majlinda Sylejmani, anëtare
17. Lulzim Rrustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar
30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Shkelzen Hajdini, DSH
5. Elmaze Behluli, DA
6. Sead Aliu, DI
7. Rexhep Rexhepi, DBP
8. Rasim Hasani, DA
9. Safete Amerrlahu, DGJK
10. Burim Rrustemi, DSHPMSh
11. Imri Semetishti, DUPMM
12. Flamur Sylejmani, DI
13. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
14. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se uroj që keni kaluar mirë në pushime pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32 -të e Kuvendit-së.
2. Propozim Vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2025-2027.
3. Raporti Janar- Qershor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.
4. Raporti i Performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2023.
5. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-9.
6. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-15.
7. Raporti monitorues për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit, për periudhën 03.07.2023 - 03.07.2024.
8. Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan (Rishqyrtim).

9. Propozim Vendim për miratimin e Planit të orareve të rrendeve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2024-2028 (Rishqyrtim).

10. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës – IADK.

Pastaj Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se me propozim të ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së, kemi edhe një pikë shtese të cilën e keni pranuar pas mbledhjes së KPF-së.

11. Raporti i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e projekt buxhetit për vitet 2025-2027

Pastaj Kryesuesi i kuvendit hodhi në votim propozimin me pikën shtesë dhe pas votimit u konstatua se me 27 vota për, u aprovua propozimi.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Albiona Tasholli, tha se pasi që po i ofrohemi muajit tetor muajit të ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit, kërkoj nga drejtorja e shëndetësisë të ndërmarr iniciativën për organizimin e aktiviteteve për informimin, që synojnë në parandalim të hershëm të kancerit të gjirit. Përveç kësaj kërkoj nga drejtorja në fjalë që nga muaji tetor të shikohet mundësia për të gjitha gratë nga mosha 40 vjeçare të bëjnë kontrollë të rregullta mamografike. Pastaj kam dy pyetje për DKA-në, gjate bisedimeve me disa studentë, kanë interesim të dinë se kur do të hapet konkursi për aplikimin për bursa. Tjetra që disa vite është bërë praktikë, që nxënësit që dy vite të pajisen, vet me pajisje shkollore edhe pse ka kaluar 1 muaj nga fillimi i procesit mësimorë, dua të dija nga DKA-ja se a kanë arritur të pajisen me materiale shkollore të gjithë nxënësit. A kanë pas ndonjë problem apo shqetësim gjatë kësaj periudhe. Një pyetje për drejtorin e bujqësisë a pritet të ketë bashkëpunime të tjera siç e kemi me IADK-në.

Arsim Jashari, tha se i kam disa pyetjeje e para, për juve kryesues i nderuar, vitin e kaluar ne kemi votuar një plan të punës për kuvend, brenda atij plani unanimisht pozite e opozitë e kemi votuar që me marr pjesë në një vizitë jashtë vendit apo brenda vendit. Pse nuk po realizohet ajo vizitë ku është problemi? Pres një përgjigje pse po ndodh kjo. Pyetja tjetër për drejtorinë e shërbimeve publike, shportat e mbeturinave në fshatra janë vendosur shumë mirë, mirëpo në fshatin Banullë ka kaluar një muaj dhe ato nuk janë zbratur fare. Ose shtoni kapacitet për pastrim ose le ti pastrojnë çdo javë. Pyetje për drejtorin e Urbanizmit deri ku ka shkuar procesi i emërimeve dhe riemërimeve të rrugëve, a keni informatë. Një rrugë në Krojmir më gjatë është shtruar me zhavor, se sa me asfalt, ndërsa përfaqësuesit e kompanisë kanë

thëne që ne e kemi me asfaltuar deri në këtë pjese. A ka mundësi me ditë ku është problemi. Ne fshatin Grackë asnjë punë nuk ka filluar a pritet të këtë ndonjë projekt. Një pyetje për drejtorin e bujqësisë është mirë me formuar një komision dhe me shkua ne secilën shtëpi sa qen të shtëpive i kanë , sepse po i mbajnë një kohë dhe më pastaj po lëshojnë qytetaret. Po ashtu po vijnë nga komuna tjera dhe po i bine në Lipjan qentë

Ardit Cani, tha se e kam një shqetësim te nxënësve dhe banorëve të fshatit Resinoc për mungesë të ujit të pijes në shkollë, ku banorët janë detyruar te marrin vet iniciativën për rregullimin e ujit ne shkollë . Pyetje për drejtorinë i infrastrukturës deri ku ka shkuar, faza e asfaltimit të rrugicave në Resinoc. Pyetje për drejtorinë e bujqësie faza e zhavorrimit të rrugëve bujqësore deri ku ka shkuar ky proces.

Herolind Kozhani, tha se e kam një shqetësim të qytetarëve të komunës se Lipjanit , ku shume vetura po parkohen afër shkollave gjatë orarit të ndërrimit, kërkoj nga ana juaj së bashku me policinë që ta bëni të pa mundurën që të parkohen ne stacionin e autobusëve në mënyrë që të mos bëhen kolona. E dyta, si është gjendja e lumit Sitnica a ka ndonjë plan për pastrimin e tij. Pyetje për drejtorin e shëndetësisë rreth bartjes se ekipës së QMF- Shalë, ku çdo mëngjes ekipi i paliatives është detyruar me i dërguar këta punëtor në Shalë, me këtë po behet diskriminim për punëtorët e tjerë.

Shahadije Bikliqi, tha se diskutimin tim do ta filloj me një vërejte teknike, për dëgjimet buxhetore 2025-2027 ku ne si asamblistë nuk jemi njoftuar për dëgjimet buxhetore dhe nuk kemi marr pjesë në dëgjime buxhetore. E dyta seancat e kuvendit duhet të transmetohen dhe në facebook, dhe të shënohet edhe emri i diskutuesit ashtu siç e bënë komuna e Shtimes. Kam pyetje për DKA-në, te shkolla “Vëllezërit Frashëri” po bëhen kolona edhe pse e kemi ngrit disa here si problematikë. Pyetje për drejtorinë e shëndetësisë, sa po respektohet orari nga barnatorët pasi që në muajin gusht pacientet janë detyruar të shkojnë në Prishtinë, të furnizohen me medikamente për pacientë. Për Drejtorinë e infrastrukturës ku vitin e kaluar Ministria e infrastrukturës ka ndarë një shumë të mjeteve se bashku me komunën për zgjerimin e rrjetit te ujësjellës dhe kanalizimit në Janjevë, por që ky projekt nuk ka ndodhur. Pse ky projekt nuk është zhvilluar? Kryetari i këshillit lokal të Janjevës ka dhënë dorëheqje 3 muaj me parë mirëpo komisioni ende nuk e ka diskutuar që të zgjidhet një kryetar i ri. Ne para disa dite kemi qenë së bashku me komitetin për komunitete në shkollën fillore “Ismail Luma” në Lipjan dhe kemi marr një kërkesë nga drejtori i shkollës që komisioni që merret me braktisjen e mësimin nga nxënësit qe te ju paguhen shpenzimet për punën shtese. Dhe kërkesa e dyte te bëhet rregullimi i kulmit të shkollës .

Lulzim Rrustemi, tha se kam një kërkesë që ne mbledhjen e radhës të na sjellni në kuvend për diskutim- plotësim rregulloren për bursa. E dyta kam një shqetësim timin personal, ndezja e pishave në Gadime një dëm tepër i madh, i një pasurie kombëtare të cilën vetë e kam vizituar dhe do të habiteni me dëmet që janë bërë aty. A ka pas ndonjë raport, se cilët kanë qenë faktorët e ndezjes, a ka pas ndonjë ndezje për shkak të kohës apo faktorët e tjerë. Jam shqetësuar pse nuk ka pas asnjë reagim nga ana e institucioneve të komunës për qytetarët.

Alban Salihu, tha se çështja e parë që dua të flasë ka të bëjë me kaosin urbanistik që ju si qeverisje lokale ja keni shkaktuar qytetit të Lipajnit, nuk keni lënë asnjë lagje pa degraduar. Siç është lagja të Xhamia, lagja të shtëpia e shëndetit dhe ajo e doktorëve, një qeverisje si kjo e juaja e ka degraduar qytetin e Lipjanit. Krejt këto nuk kanë ndodhur nga mos dija apo mos profesionalizmi apo nga logjika gllabëruese e kryetarit. Shume kompani që ndërtojnë në Lipjan janë të afërta me kryetarin, apo me drejtoret e tij. Çështja e dytë që do të flas është shpronësimet e pa ligjshme që po ju bëhen pronave private, ku kemi marrë shume ankesa nga qytetarë që ju kanë shpronësuar pronat e tyre pa ndonjë bashkëpunim, shumë prej tyre kanë ngritur kallëzime penale, ndaj kryetarit të komunës dhe e kanë kundërshtuar në gjykatë, mirëpo kryetari as që i pret vendimet e gjykatave. Pse po ndodh kjo?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, se shpronësimet e pronave i ka bërë kuvendi jo kryetari. E dyta konfirmimi është bërë nga ministria juaj e jo e LDK-së. Dhe e treta nuk është mirë me të lexuar letrat e të tjerave. Ndezja e pishave njëra nga temat me brengosë, që i ka bërë dem jo vetëm asaj pjese po të gjithë qytetarëve. Vizite ka pas nga nënkryetari së bashku me drejtoritë përkatëse. Ka pas asamblistë që kur është dëmtuar diçka unë e kam postuar në rrjetet sociale, ka pas akuza nga disa prej juve pse po i poston. Asetet nuk janë as të kryetarit e as të ish kryetarit ato janë të gjithë qytetarëve dhe duhet të gjithë të reagojmë. Konkursi për bursa do të publikohet nga mesi, apo fundi i tetorit. Për rregulloren për bursa nëse ka nevojë mu ndryshuar e ndryshojmë. Ne kemi filluar me aktivitet për muajin rozë prej vullnetarëve dhe drejtoratve dhe do të jetë në funksion mamografi në Lipjan. Marrëveshje ne do të nënshkruajmë me këdo që na ofrohet mundësi për të mirën e qytetarëve të komune tonë. Për vizitat jashtë shtetit bisedoni me shefat e grupeve me kryesuesin unë nuk përzihem në çështjet e juaja. Shportat e mbeturinave e drejte kemi pas një telashe por do ta ripublikojm shumë shpejtë. Po ashtu edhe për mirëmbajtjen e lumenjve ku do të përfshihet dhe lumi Sitnica. Procesi i emërimeve dhe rriemërimeve goxha me telashe, po si do që dakordoheni ju shefat e grupeve unë pajtohem. Qentë endacake është problem që nuk po mundemi veç ne si komune me të zgjidh, pasi që po na bien qenë

edhe nga komuna tjera. Ne Grackë janë bërë disa investime, ka mbet vetëm trotuari dhe ndriçimi. Parkingu te shkolla e mesme është shqetësues ne po mendojmë qe ta rrisim parkingun brenda oborrit te shkollës. Asnjë investim nuk e kemi pas nga qeveria qe 3 vite.

Besiana Syla, tha se i kam disa kërkesa te qytetarëve ne fshatin Magure ka filluar një projekt për rregullimin e shtratit te lumit, mirëpo një pjese është ndërprerë për shkaqe politike. Mbi 60 hektarë toke ne fshatin Gumnasellë janë mbet te pa punuara, shkaku e një ure qe nuk është ndërtuar qe 3 vite. Po ashtu ne fshatin Gumnasellë është një rruge afër shkollës afër 300 metra qe mungon kanalizimi. Banorët e fshatit Bujan përballen me ujëra te zeza shkaku i bllokimit te kanalizimit. Ne QKMF në Lipjan ka mungese te dhomave për infuzione, kërkoj nga drejtoria e shëndetësisë te merret me këtë çështje.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se një kërkesë e prindërve të nxënësve nga klasa 6 deri 9 qe zhvillojnë mësimin ne shkollën “Adem Gllavica” lidhur me numrin e tualeteve, te cilat nuk po kanë kapacitet me i mbuluar 400 nxënës, është mirë me shikuar mundësinë me i rrite numrin e tualeteve ne shkolle. Banorët te objekti i Euro Kosit ju kane drejtuar komunës, për prishjen e parkut dhe ndriçimit publik, i cili është prishë nga mirëmbajtësi, i cili me apo pa qellim e ka prish ndriçimin publik dhe qytetaret ju kane drejtuar me petition komunës, andaj kërkoj nga drejtoria përkatëse një sqarim lidhur me këtë çështje. Tjetra ne kemi vizituar shkollën “Ismail Luma “ ku e kane qendrën për mësim shtesë, kjo qendër ka rreth 50 nxënës dhe 2 tutor, të cilët qe disa muaj nuk kane marr paga. Kërkoj nga komuna qe sipas mundësive qe te beje një zgjidhje për pagese për këta tutor. Çështja tjetër, banorët e rrugës “Zylfie Gashi,” te cilët po kane probleme me parkim te veturave, duhet te ju behet një zgjidhje. Tjetra u përmend nga kolegja qe ne muajin e kancerit te gjirit te këtë aktivitete, unë e kam një propozim objekti i komunës dhe QKMF-se, te behet me ngjyre rozë.

Rinor Murati, tha se kam një kërkesë te banorëve te rrugës “Sadik Shala” qe te behet vendosja e policëve te shtrire, pasi qe një është vendosur ne atë rrugë, por jo e mjaftueshme. Kërkesa e dyte te behet rrënimi i shtëpive të cilat po rrezikojnë banorët në fshatin Janjevë.

Fadil Spahiu, tha se kam dy kërkesa. E para ka të bëjë me DSHPMM, ku punë kryesi gjatë punimeve te shtratit te lumit ne fshatin Smallushe ka dëmtuar rrjetin e kanalizimit dhe ka kohe qe nuk po funksionon, ka disa muaj qe është bllokuar dhe nuk është bere asnjë intervenim. A ka qene dikush nga komuna për ta shikuar këtë? Kërkesa e dyte për drejtorinë e infrastrukturës për mirëmbajtën e rrugës “11 qershori”

te kyçja te autostrada, ku është dëmtuar shume nga punimet qe po behën ne autostrade.

Arsim Jashari, tha se ndryshimi i emërimeve ka me qen problem, por unë kam propozuar qe emërimet e reja mi përkundu. Është mire me u nda vendimi njëherë me u marr me emërimet pastaj me riemërimet. Dhe tjetra eshë mire me i shikuar procesverbalet dhe mos ti përsërisim kërkesat dhe mos ti marrim kërkesat e njeri tjetrit.

Alban Salihu, tha se unë dola për dy çështje, e pra për kritikata qe po ua jepni qeverisë për ndërtimin e shkollës se mesme ne Lipjan, pse ju nuk po e ndërtoni shkollën fillore ne Lipjan te cilën e keni premtuar.

Ardit Cani, tha se ujin ne shkolle e kane nderuar vet banoret kryetari i fshatit me iniciativën e tyre, pasi qe aty nuk ka pas ujë, pse nuk ka pas ujë aty?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se unë i pyeta për shkollën ne Risinovc dhe aty paskan ujë. Defekti i rrjetit te kanalizimit ne Smallushe është e vërtet ka ndodh gjate rregullimit te shtratit te lumit dhe do ta rregullojmë shume shpejte, po ashtu me dëmtimin e rrugës jo vetëm ne Smallushe por edhe vende tjera ka nevojë për sanimin e rrugëve. Për parkingje ne jemi te detyruar ti vendosim shenjat ne i kemi vendos pastaj është çështje e policisë pjesa tjetër. Për çdo aktivitet për këtë muaj ne do ta mbështesim. Defekte ne kanalizim ka shume, por është e pa mundshme te gjitha me u zgjidh për një ore apo për një dite. Ne Janjeve kemi një projekt për restaurimin e rrjetit te kanalizimit.

Shahadije Bikliqi, tha se ne faqen e komunës është postuar restaurimi i kanalizimit dhe ujësjellësit ne Janjevë ne marrëveshjen e nënshkruar ne mes ministrisë dhe komunës.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se memorandumit e mirëkuptimit nuk janë zbatuar nga ministritë relevante, unë kam deklarua dhe deklaroj prape qe memorandumet nuk janë implemetuar nga ministritë, vine i nënshkruajnë sa për reklamë dhe asnjë pune te hajrit nuk e bëjnë.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 32-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 24 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 32 të, e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2025-2027.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Ganimete Qeriqi, tha se po shihet qe keni nda mjete për ndërtimin e kullës muze në fshatin Krojmir, disa qytetarë me kane pyetur. Ku do te vendoset ajo kulle dhe ku do të jetë lokacioni, është mire qe ajo kulle te ju përgjigjet te gjithëve dhe te jete ne mes te fshatit dhe duhet me shume te ju përgjigjet atyre qe kanë dhënë gjak. Pres një përgjigje për ketë çështje.

Alban Salihu, tha se siç e kemi thënë dhe me herët ne buxhet e kaluara ,po përsëritet gabimet e njëjta. Një buxhet aspak kreativ dhe aspak gjithëpërfshirës, ku nga 7 milionë euro vetëm 8% është planifikuar për fshatra, duke mos i përfshirë dy stadiumet famëkeqe. Ky buxhet ka edhe shume anomali tjera dhe ne do ta votojmë kundër.

Armend Grajqevci, tha se një buxhet i planifikuar mire, një buxhet gjithëpërfshirës, ku janë përfshirë te gjitha fshatrat me nga një projekt, nga Brusit deri ne Kleçkë, ku 88% e kërkesave te qytetarëve janë përfshire në ketë buxhet. Përveç tjerash karakteristike e këtij buxheti janë investimet kapitalë. Me interesantja është rritja e shërbimeve mjekësorë ne QKMF dhe QMF, po ashtu edhe ndërtimi i monumenteve kulturore, siç është shtëpia e kulturës dhe shtëpia me identitet e UCK-së ne Krojmir. Andaj ne grupi i LDK-së e mbështesim dhe presim qe edhe grupet tjera ne asamble, ta mbështesin këtë buxhet.

Lulzim Rrustemi, tha se një pike shume e veçantë pasi qe votohet buxheti për 3 vitet e ardhshme, me rëndësie është buxheti i vitit te ardhshëm. Një buxhet mbi 24 milion, i ndare ne grante. Po kalojmë te shpenzimet kapitale ku për vitin 2025 janë gjithsej 16 projekte ne infrastrukturë rrugore. Vetëm 13 % e buxhetit është paraparë

neper fshatra. Është një buxhet i koncentruar vetëm ne projektet te mëdha, dhe mungojnë projekte ,për hapësira publike, po ashtu ne arsim ka pak mjete. I mungon qytetit të Lipjanit një shkolle fillore. Zgjidhja e arsimit ne komunën e Lipjanit mungon edhe këto vite, po ashtu uji i pijshëm problem për shume fshatra. Te dëgjimet buxhetore ne kemi pas edhe shume kërkesa, si shkolla e Banulles, rruga Kojske-Toplqian, trajtimi i ujerave të zeza, dhe shume kërkesa te tjera dhe asnjëra nuk eshte marr parasysh. Ne nuk do ta votojmë këtë buxhet pasi qe nuk ka projekte qe janë te nevojshme për qytetaret. Dhe plot arsye nuk do ta votojmë këtë buxhet.

Bashkim Budakova, tha se kemi te bëjmë me një pikë te rëndësishme për qytetaret ,është buxheti i komunës se Lipjanit, i cili bushet është mbi 6 milion euro, ku shumica e mjeteve janë shkuar për parking dhe nënkalm, qe i bie qe është prish një parking për një parking, dhe një rruge për një nënkalm. Më e drejte do te ishte një nënkalm te hekurudha, pasi qe shume shpejt do të jetë në qarkullim linja hekurudhore. Me këtë nënkalm kemi te bëjmë me një kopje të lodhtë te komunës se Ferizajt. Kërkesat e qytetarëve nuk janë marr parasysh apo me mire me thëne nuk janë përfill fare nga ana e ekzekutivit. Pasi qe shume fshatra kane probleme elementare si: mungese te ujit të pijes, kanalizimit dhe trotuarit. Shumica e fshatrave nuk kane asnjë projekt për këto vite duke i përfshire edhe fshatrat e lokalitetit nga vije unë Rubovc dhe Kojskë dhe shumë fshatra te tjera.

Shahadije Dragaqina, tha se një nder kërkesat baze gjate dëgjimeve buxhetore gjatë këtyre viteve kane qene shtrirja dhe zgjerimi i rretit te kanalizimit në ato fshatra ku mungojnë këto dy elemente bazë. Është për gjynah qe një numër i madh qytetarëve kane mungesën e këtyre të dyjave. Këtu kemi një buxhet te planifikuar keq dhe qe nuk merren për baze asnjëherë kërkesat e qytetarëve. I gjithë buxheti është i fokusuar ne 4 projekte te mëdha ne qytet, ndërsa ne fshatra thuajse nuk është asnjë projekt. Kam një pyetje për drejtorin, lidhur me konstruktimin e ndriçimit publik ne Janjevë a është planifikuar për vitin 2025 a është në bashkëfinancim me ndonjë Ministri.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se e propozoi drejtori me heret qe ka me u hiq, pasi qe është lidhe kontrata por nuk e paskeni dëgjuar.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se i kam disa propozime te cila i kam ngritur edhe në dëgjime buxhetore, por nuk janë marr parasysh. E para ndriçimi dhe trotuari ne rrugën “Bnaush Sadllari” në Shalë te përfshihet. Po ashtu mungon edhe ndriçimi publik ne fshatin Jeta e Re. Kërkesa e drejtorit të shkollës “Ismail Luma” në Lipjan

është rregullimi i kulmit të shkollës. Tjetra rikonstruktimi i rrugës Sllovi Dobratin është shtyrë për vitin 2026 pse po shtyhet kjo rrugë që disa vite.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se deri këtu janë marr parasysh shumë indikator dhe parametra. Unë jam i vetëdijshëm që nevojat e qytetarëve janë të shumua. Asnjë nga këto projekte nuk janë bërë për sy e faqe, por janë premtuar në fushatë e të cilat i kanë premtuar edhe partitë tjera, ndërsa sot nuk po i votoni. Në përveç këtij buxheti kemi dhe projekte tjera nga granatet për të mirën e qytetarëve. Tjetra komuna është përgjegjëse për me investuar në ujësjellës, por ne nuk menaxhojmë, dhe ne kemi investuar edhe në Janjeve edhe në fshatra tjera. Kompania nuk i jep përgjegjësi komunës por qeverisë. Pse nuk ka ujë drejtoni qeverisë. Ujësjellës në fshatra kemi kontrate me CDI, por ata kanë probleme të veta dhe ne nuk po mundemi me ndërhy deri të na dorëzonjë këtë. Për këtë kemi dhe shkresë që ju kemi dorëzuar. Nëse CDI heq dorë në do ta marrin përsipër. Shkollë kam premtuar unë në Lipjan për ndërtim, por cili nga ju i ka fëmijët në shkollën Ismail Luma, secili nga ne i kemi në shkollën Vëllezërit Frashëri, dhe cili me garanton që nëse ndërtojmë shkollë nesër do ti dërgoj fëmijët në atë shkollë të re. Unë kam premtuar shkollë edhe ajo shkollë do të bëhet. Në Rubovc është bërë shkollë, fusha e sportit, trotuari, ndriçimi publik dhe projekte tjera, Unë ju propozoj që ta votoni buxhetin.

Lulzim Rrustemi, tha se neni 17 i ligjit për vetëvrasje, thotë që komuna ka obligim me investuar në ujësjellës, dhe shumica e qytetarëve në komunën e Lipjanit nuk kanë ujë të pijes. Është dashtë të ndahen me shumë mjete sa i përket ujit të pijes.

Shahadije Dragaçina, tha se ka qene renovimi i shkollën në Janjeve dhe disa fshatra tjera, mirëpo unë nuk po e shoh që është në buxhet pse?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se nëse e lexoni ligjin për menaxhimin e ndërmarrjeve publike e në cilin nivel është kompetenca e komunës e para, e dyta investimi është obligim i komunës jo menaxhimi pasi që nuk na lejon ligji. Renovimi i shkollës së Janjevës do të fillojë shumë shpejtë.

Latif Ramadani, tha se në Krojmir do të ndërtohet në lokacionin aty ku e cakton këshilli i fshatit së bashku me të tjerët.

Ganimete Qeriqi, tha se lokacioni që po flitet se është i pa përshtatshëm dhe nuk po me duket i arsyeshëm pasi që kulla duhet të ju përgjigjet të gjithëve.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se për mua nuk janë heronj vetëm ata që kanë vdekë, janë edhe të gjallët, sepse kush ka qen në lufte ka mujme me qen i vrare, ajo shtëpi unë e kam mbështet dhe këshilli i fshatit e cakton lokacionin

Daut Azemi, kryesues i kuvendit me ndryshimet e cekura me larte, që te hiqet projekt i Jnajeves dhe shtohet projekte rikonstruktimi i rrugës në Dobarje te madhe ndërsa 10 mijë euro kaloje ne bashkëfinancim me donator.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, 11 kundër aprovoi propozimin buxhetin për vitet 2025-2027.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se po shkojmë në pauze nga ora 12:00 deri në ora 13:30

Pastaj, pas pauzës u kalua ne piken në vazhdim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se kam kërkesë me shty këtë pikë për pak me vonë pasi që kryetari për momentin ka një takim zyrtar deri ta përfundon pastaj vazhdojmë me atë pikë. Me pas tha po vazhdojmë me piken e 4, të rendit të ditës.

IV

Raporti i Performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shemsi Azemit, koordinator i performancës i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se raporti i performances shifrat falsin vet. Edhe pse ne jemi opozitë duhet me ju gëzuar kësaj pasi që është në te mirën e qytetarëve. Ajo që po me intereson te barazia ne punësim pse kjo shifër kaq e ulet punësimet familjare apo çka ndikon?

Albiona Tasholli, tha se ne baze te këtij raporti komuna ka treguar një performancë te shkëlqyer në përmbushjen e detyrave te saj duke u dalluar ne efikasitet ne ofrimin e shërbimeve për qytetaret. Komuna ka fituar besimin e qytetarëve duke punuar me përgjegjësi dhe profesionalizim.

Shahadije Bikliqi, tha se te raporti i performances evidentohen me performance te ulet ato çështje te cilat ne asambleistët i kemi ngritur. Hiç me larg se sot, siç është

infrastruktura rrugore e këtu që janë mungesa u ujësjellësit dhe kanalizimit. E dyta përgjegjshmëria komunale del se janë konsultuar me publikun për akte dhe dokumente publike dhe kanë marr përqindje të lartë. Edhe të KABI, po ashtu përqindja e grave në dëgjime buxhetore, por në të dimë që këtu ka pjesëmarrës të vogël të qytetarëve e kjo shihet edhe në fotot e postuara në faqe të komunës. Asgjë nuk ka bërë komuna për gra nuk ju ka ndarë mjete lehonave as rasteve të tjera. Tjetra të drejtorja e kulturës çka ka bërë qeverisje për kulturën për mua është zero.

Alban Salihu, tha një raport me gabime sintaksore ashtu edhe morfologjike. Në disa fusha nuk janë rezultatet për tu pranuar, për shembull hapësirat publike për të cilën në kemi pas disa here reagime, infrastruktura rrugore, mungesa e kualitetit në investime, ku shumë projekte pas investimit kanë filluar defektet. Po ashtu edhe të përfaqësimi gjinor kemi situatë jo të mirë. Ky raport duhet të kthehet edhe një herë dhe të përmirësohet.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se Shemsi mund të ju shpjegojë indikatorët se si nxirret përqindja. Prsh të konsultimet publike merret nr. i popullatës pjesëtohet me 205, pastaj nga ai del përqindja. Këto janë norma të caktuara në baze të rregullores për performancat. Në të plotësojmë të gjitha kriteret pastaj vlerësimin e bën dikush tjetër. Në statutin tonë kemi ende fshatra që janë me Graqanices, po ashtu i kemi edhe disa fshatra që nuk e kanë asnjë banorë, fshatrat e braktisura, si Okosnica, Shisharka, Vogoqica dhe të këto na dal investimi të kanalizimit dhe ujësjellësi keq. Unë i falënderoj zyrtarët për përkushtimin madh.

Shemsi Azemi, tha se të barazia në punësim janë 5 tregues, këtu është të të punësuarit me nevojë të veçanta në kuadër të komunës, po ashtu të komuniteti jo shumicë. Pjesëmarrja e qytetarëve merret numër i përgjithshëm, i pjesëmarrësve dhe grave dhe pastaj na del treguesi automatik në bazë të përqindjes. Në të falënderojmë të gjithë zyrtarët e komunës për mbështetjen që na kanë dhënë.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

III

Raporti Janar- Qershor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Ahmetit, kryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ajo qe dua te ndalem te sektori i personelit, nuk e kemi në raport anulimin e konkurseve, duhet ceket baza ligjore pse po anulohet. Duhet te ndërmerren masat. Te kontratat kolektive edhe pse nuk është fajtorë komuna dhe po rritet borxhi i komunës ma shume sepse ministria nuk parasheh mënyre me i paguar dhe ato do te heqin prej një kodi.

Alban Salihu, tha se një raport formal qe shumica e punëve ishin kryer edhe mos me pas hiç kryetar. Po ashtu për punën e drejtoreshave nuk ke se çfarë te thuash kur dihet se shumica e qytetarëve as qe i njohin për ndonjë punë.

Lulzim Rrustemi, tha se këto tema i kemi diskutuar edhe ne raportet e buxhetit, por do te jem i shkurte. Ne këtë raport te sektori ne marrëdhënie me publikun është një përsëritje e periudhave te më parshme duhet te përmirësohet. Te arsimit ka punësim me lidhje familjare, nepotizëm. Duhet te ketë profesionalizëm meritokraci e je te shkoj gjithë me te njohshëm. Punësojnë staf qe nuk është profesional dhe adekuat. Po ashtu ne raport ka gabime teknike e gjuhësorë te drejtoria e arsimit. Po ashtu mungojnë një shume e mjeteve. Te kultura nuk figuron fare çka ka ndodh më stadiumet ne Magurë ne Dobrajë. Shtëpia e kulturës qe dy vite e dështuar. Te buxheti, taksat nga tregu i kafshëve dhe tregu i gjelbër për 6 muaj asnjë cent e hyre ndërsa te planifikuar janë 35 mijë euro. Te administrata nuk kemi asnjë informate për pagesën e komisioneve dhe komiteteve . Nuk është shkruar asnjë rresht për mos pagese te këtyre mëditjeve, nuk është bere asnjë analize pse nuk janë paguar këto.

Fitim Mëziu, tha se një raport voluminoz, por unë do te ndalem të shëndetësia, për kundër një numri te madh te arritjeve dhe përmirësimit te shërbimeve shëndetësore ne komunën tonë Kur hyjmë ne gjera me te imëta shohim disa vërejte te cilat mund ti hasim gjatë përpilimit te raportit. Ne raport shohim mbi 50 mije shërbime shëndetësore gjysma vetëm ne emergjencë gjysma ne mjekësi familjare. Ajo qe me ka ra ne sy, 3 mjek i bjen qe i kane vetëm 1.8 pacientë ne ditë. Duhet te jete një raport se cilët janë ata mjek qe nuk ofrojnë shërbime shëndetësore dhe ne fund marrin mirënjohje. Po ashtu barnatoret nuk po kujdestarojnë ,duhet te behet një takim me shefat e barnatoreve dhe te diskutohet për ketë çështje.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha sa i përket barnatoreve ka pas probleme por do te dalim me një agjende te re. Drejtori mundet me u referuar vetë. Tjetra, te hyrat te tregu janë te kodi 50405 te hapësirat publike. Shtëpia e kulturës qe një kohe të gjatë jemi në OSHP me konkursin e projektimit. Te punësimet unë as kam pruar gra

te drejtoreve, as fëmije të drejtoreve, ne pune dhe është e pamundur pa qëlluar dikush me dike i pa njohshëm. Dhe çdo pune monitorohet dhe zyrtaret nuk e kanë aspak te lehtë sepse nuk kanë aspak stimulim dhe ju e dini se çfarë paga kanë zyrtaret e komunës. Unë kam punësuar dhe familjarë të dëshmorëve invalidëve dhe tani i keni ne punë.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

V

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-9.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne kemi pas një anëtar tonin ne komision dhe dy propozimet i mbështesim me votën tonë.

Alban Salihu, tha se unë po e jepi qëndrimin për të dy pikat, ne do te votojmë kundër jo për shkak te përfituesve, por për shkak te mos besimit qe kemi ndaj juve do te votojmë kundër.

Lulzim Rrustemi, tha kemi te bëjmë me një pike, për një zone qe nuk ka zhvillim. Me këtë proces asaj zone ka me ju kthye një dinjitet tjetër, dhe kjo kompani është një investues i madh dhe ne i kemi zbatuar te gjitha kriteret dhe i kemi përzgjedh këto dy kompani për këto parcela. Pasi qe janë kompani serioze dhe ky është synimi i komunës qe me u zhvilloj sa me shumë. Ne do ta votojmë pro.

Armend Duriqi, tha se sa i përket këtyre parcelave ka qene një komision i cili ka bere një pune shume te mire, ka pas disa te interesuar. Ne i kemi përzgjedh këto dy biznese në baze te kriterëve dhe këto biznese do ta zhvillojnë atë pjese dhe do te këtë te punësuar ne atë pjese qytetar te komunës tone. Dhe si grup i LDK-së do ti mbështesim te dy propozimet.

Latif Ramadani, tha se e kam një vërejtje, për parafolësin qe tha nuk kam besim, Është shumë e pa ndershme për një komision qe ka punuar aq shume me përpikëri me pas mendim te tillë.

Alban Salihu, tha se unë pse thash nuk kam besim ne juve, nuk do me thanë qe secilin prej juve, por nuk kam besim ne ty.

Latif Ramadani, tha se mua me behet qejfi kur ti nuk ke besim ne mua, mirëpo është mire me pas te paken minimumin e respektit për anëtarët e komisionit, te cilët i kane respektuar kriteret ne maksimum.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, 4 kunder,1 abstenim, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit P-71409059-00559-15.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, 4 kundër, 1 abstenim aprovoi propozimin

VII

Raporti monitorues për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit, për periudhën 03.07.2023 - 03.07.2024.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, drejtor i DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë e vlerësoj punën tënde, por do te ndalem te dhënia e lejeve ndërtimore, pasi qe kriteret nuk po respektohen për dikë. Ata qe donë me ndërtua ne komunën e Lipjanit, e projektin e marrin ata qe punojnë ne komunë leja e ndërtimit jepet më shpejtë, procedurat kryhen më shpejtë. Ndërsa ata qe nuk i marrin projektin nga brenda ata kane shumë problem me marr leje. E dyta a dilni ne teren

me pa gjendjen faktike si po ndërtohet. Tjetra është ndërtuar një kat i një lamellë edhe askush se ka pa, derisa unë e kam ngrit ne kuvend. Shumica e inventarëve kane ikur nga komuna e Lipjanit. Ose respektoni kriteret për te gjithë njëjtë ose mos lëshoni pe për askënd. Pyetje brenda hartave zonale pse nuk po zbatohet rregullorja për bonuse? Pse nuk zbatohet vetëm ne komunën e Lipjanit.

Shahadije Bikliqi, tha se kam disa pyetje, ne njërën ane po paraqitën si të suksesshme hartat zonale, ne anën tjetër kemi kriteret te cilat janë paraqitur si sfide ne fushën e ndërtimit. Me këtë rast a i ka ra mirë komunës apo keq me harta zonale? Tjetra a e din komuna sa objekte pa leje i ka? Cilat janë vendbanimet ne te cilën do te behet zhavorimi i rrugëve.

Alban Salihu, tha se kam një pyetje për drejtorin, se a mundësh me siguria publikisht qe lejet ndërtimore aplikohen për te gjithë njëjtë, pres përgjigje.

Rinor Murati, tha se sa i përket legalizimit të objekteve e shoh një numër te vogël te kërkesave, ne raport me numrin e objekteve dhe shtëpive qe janë. Konsideroj qe duhet te këtë një fushate me intensive qe te behet kjo.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se gjatë diskutimeve po ka mos përputhje. Gjatë pyetjeve u tha se po ka ndërtim dhe është sterngarkuar qyteti, ndërsa tani po thuhet se nuk po ka ndërtime se është bere e vështir me marr leje. Tjetra asnjë biznes i Lipjanit nuk ka ikur nga Lipjani. Ka biznese te Lipjanit qe kane shkuar me ndërtuar diku tjetër ne Ferizaj apo diku tjetër, por janë duke ndërtuar edhe ne Lipjan. Bizneset e këqyrin interesin e vet. Hartat zonale i kane pas disa defekte.

Imri Semetishti, tha se me përgjegjësi te plote e them se kriteret e hartës zonale janë respektuar dhe vazhdojnë te respektohen me rigorozitet te plotë. A ka dallime prej kriterëve, po ka varësisht prej parcelës, prej zonës, dhe kushteve qe ka përcaktuar harta zonale. Ndihem krenar qe kam ndryshuar shume konfliktin e interesit për lejë ndërtimore e kam evituar shume. Ne i kemi kushtet për leje ndërtimore, ndërsa pjesa tjetër i takon inspektoratit. Afatet për kryerjen e lejeve janë ne përputhje me afatet e përcaktuar ligjore. Por kemi raste kur palët aplikojnë me dokumente jo complete dhe kjo shkakton zvarritje deri ne finalizimin e një kërkesë. Lipjani ende nuk e ka rregulloren për bonuse për shkak të telasheve që kane hartat zonale. Hartat zonale po zbatohen në nivelin më të larte të mundshëm, është zbatuar për 3 vite ne maksimum. Sot kemi mbi gjysmë milioni te hyra, falë dhënies se lejeve ndërtimore. Te zhavorrimet e rrugëve nuk e di sepse te dhënat i kam marr nga drejtorati për bujqësi. E ceka edhe

me herët se të gjitha kriteret zbatohen në baze të hartave zonale, varësisht prej lokacionit apo kategorisë së rrugës.

Arsim Jashari, tha se unë nuk thash se ju duhet me dal në teren me shikuar apo zbatohen kriteret ose jo. Një pjesë e njerëzve që e kanë lanë punën kanë veprua në këtë mënyrë, kanë bërë projektet. E dyta mos të kish qen gabimi i hartave zonale e kishim hartuar edhe rregulloren për bonuse . Tjetra për kryesuesin shumica i investitorëve po ikin sepse kriteret janë me të mëdha, dhe një metër e banesës kushton në Lipjan 700 euro, ndërsa në Ferizaj me 500 euro. Sot me një pagë është vështirë me ble një banesë në Lipjan.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha se kërkesa për të blerë banesë po është e madhe, dhe ndërtuesi kanë shkuar në komunën tjetër sepse ka gjetë hapësirë me shumë.

Imri Semetishti, tha se kaosi urban është për shkak të koncentrimit në zonën e parë të qytetit. Qytetarët me të drejt apo pa të drejt po blejnë banesë në qendër të qytetit. Edhe pse harta zonale është dashtë me i balancuar këto.

Fadil Spahiu, tha se rritjen e çmimit të banesës në Lipjan e kanë bërë kriteret e pa drejta të hartës zonale.

Arsim Jashari, tha se nga fillimi i vitit shumica e shtëpive janë tatimuar edhe për pronë bujqësore, ku shumica e shtëpive janë në toka bujqësore dhe nuk janë të përkthyer a po janë në emër të dikujt tjetër. Dhe ky ka me qenë një problem i madh. A ke ndonjë informate për këtë çështje?

Rinor Murati, tha se u përmend çmimi i lartë i banesave, ndoshta edhe zhvillimi i hovshëm ka ndikuar që të këtë rritje të çmimit.

Imri Semetishti, tha se kemi një numër jo edhe aq të vogël të aplikuesve që nuk e kanë të zgjidhur çështjen pronësore dhe po është sfidë e madhe. Ne po jemi të pa fuqishëm me ndikuar. Deri tani nuk ka asnjë iniciativë për rregullimin e trashëgimisë dhe tatimit në pronën e paluajtshme. Sa i përket çmimeve të rritjes nuk di çfarë të them, ndoshta edhe afërsia me Prishtinën dhe çështje të tjera kanë ndikuar në rritje të çmimit.

Fadil Spahiu, tha se kur po ipen lejet për ndërtim, një pjesë po caktohet për parking, pastaj ajo po shitet. Ndërsa qytetarët po detyrohen me i parkuar veturat në parking publik. Çka me vepruar në këtë rast qytetarët sepse ata në fillim po e marrin lejen për parking, pastaj po ua shesin qytetarëve.

Imri Semetishti, tha se çdo ndërtesë që ka njësi banesore, duhet ta këtë edhe parkingun, që e obligon blerësin e banesës që ta blejë dhe parkingun dhe shitësit të ia kushtëzoj blerjen e banesës me parking.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenime, aprovoi raportin.

VIII

Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan (Rishqyrtim).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkezen Hajdini DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturiye Bytyqi-Hasani, tha se kam frikë që prape do të na kthehet për shkak të jo profesionalizmit nga ana e ministrisë. Pasi që një here e kthen një nen pastaj një nen tjetër. Unë kur e kam bërë krahasimin e nenit 5 dhe 13 dhe ka vërejte të emërtimet. Unë rekomandoj që kjo pike me u shtyrë. Unë i kam disa vërejte që të neni 2, të mbetet vetëm QKMF, të hiqet emërtimi edhe jo vetëm të këto dy nene por edhe të gjitha nenet tjera ku përmendet emërtimi dr Mehdi Zejnullahu. Duhet të fshihen edhe pika 5.7 dhe pika 5.8. Ndërsa të neni 2 paragrafi 2 të shtohen dhe udhëheqësja. Pra ashtu siç e thash me herët aty ku është Mehdi Zejnullahu, të hiqet emërtimet. Në grupi i PDK-së vazhdimisht e kemi votuar por nëse kthehet prape në nuk do ta përkrahim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, nuk po kemi me kane me harmonizuar, sepse ata nuk po na përgjigjen. E dyta se kape logjika me thënë harmonizojë qet nen sepse këta e ke gabim, ndërsa herën tjetër thotë harmonizoj këto të tjerat. Dhe e kane pranuar ata gabimin që sipas tyre se kemi dite që është rishqyrtuar, Dhe specifikat që i ka komuna jone nuk mujnë me i pas edhe komunat tjera.

Arsim Jashari, tha se e dhamë mendimin si grup, por duhet me qen konstruktiv, kur shkon një dokument në ministri duhet të analizohen rend e jo një here një nen pastaj neni tjetër. Kjo është non sens është maltretim edhe për neve anëtarët e kuvendit, sot po e shqyrtojmë një nen, nesër një nen tjetër, duhet të këtë harmonizim. Unifikimi mundet me qen në rregull mirëpo, specifikat si kanë të gjitha komunat njëjtë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ne si kuvend mundem edhe me votuar kundër, me lanë atë statutin qe ka qen më herët. Ne mundem me i ndryshuar ato qe tha Lumja, mirëpo çka nëse i kthen prape thonë pse këto i ke ndryshuar.

Fitim Mëziu, tha se e kemi diskutuar dhe më herët për statutin ,çështjet themelore i bën ligji sepse komunat kane specifika te ndryshme. Neni 3 duhet te ndryshohet sepse nuk është formuluar mire, QKMF nuk ka filluar punën para vitit 1959, duhet te formulohet QKMF ne vitin 1959 ka punuar punën si shtëpi e shëndetit, sepse QKMF ne vitin 1959 nuk ka pas. Para se me u qit ne votim kjo duhet te ndryshohet.

Shkelzen Hajdini, tha se nuk bën te shtyhet duhet te vazhdojmë tutje. Te fshihet emrtimi8, nuk është problemi te emërtimi por te shërbimet. Dha se kjo forme unike po bëhen ne baze te udhëzimit, mirëpo ne kemi specifika te ndryshme nga komunat tjera, dhe unë nuk them qe me i qua në shpi 50 punëtor. Ne nenin 3 mund ta ndryshoni ashtu siç po thotë asamblisti. Ndërsa emërtimi nuk bën te ndryshohen se ne kuvend ju ka ve emri Mehdi Zejnullahu. Ne i kemi disa shërbime nuk mujm me i hekë ato.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se te neni 3 pika 1,te emërtimi, te neni 2 te shtohet historiku.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne faqen e pare shënohen Statuti i QKMF Mehdi Zejnullahu, ne neni 2 pika 3 te shënohet historiku se si ka ardh deri te QMF, dhe tash dr. Mejd Zejnullahu, me pëlqeu ideja e dr. Propozimi im është kështu, te shtohet 2.4 dhe të behet kështu, me vendim te kuvendit komunal të datës 18.07.2024, me nr. 15-112-05-40303 është emërtuar dr. Mehdi Zejnullahu.

Daut Azemi, thash po e dëgjojmë propozimin tjetër.

Fitim Mëziu, tha se neni 2, pika 3 , QKMF DR. Mehdi Zejnullahu ne Lipjan ka filluar punën si shtëpi ne vitin 1959, pastaj te neni 4, shtohet të behet kështu, me vendim te kuvendit komunal të datës 18.07.2024, me nr. 15-112-05-40303 është emërtuar dr. Mehdi Zejnullahu.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, ,2 abstenim, aprovoi propozimin

Propozim Vendim për miratimin e Planit të orareve të rrendeve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2024-2028 (Rishqyrtim).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën, Burim Rrustemit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne e kemi diskutuar edhe ne KPF, dhe jemi për me votuar, mirëpo nuk është e drejt ajo ndarje nga ana e ministrisë, por në do te votojmë pro.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, 2 abstenim, aprovoi propozimin.

X

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës – IADK..

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepi, DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota, për aprovoi propozimin.

XI

Raporti i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e projekt buxhetit për vitet 2025-2027

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16:00.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi